



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:286250
Datë: 01.02.2024
Numri i dokumentit: 05274625

C.nr.7480/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses P.K Sh.p.k., me numër unik identifikues 8....., me seli në Zonën Industriale, Magjistralja Prishtinë – Fushë Kosovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurve N.K, V.K, që të tre nga Prishtina, Lagja ..., rruga “”, Kompleksi”, Hyrja, kati, nr., B.K, L.K, dhe Sh.K, që të tre nga Prishtina, Lagja, rruga “”, Hyrja, nr., si dhe D.K nga Fushë Kosova, rruga “”, Objekti, Kati, nr., e të cilët i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “”, me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen kontestimore pengim posedimit, pas mbajtjes së seancës përgatitore me datën 29.01.2024, jashtë seance me datë 01.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË SI E PALEJUESHME padia C.nr.7480/22, e datës 30.12.2022, e paditëses P.K Sh.p.k., me numër unik identifikues , me seli në Zonën Industriale, Magjistralja Prishtinë – Fushë Kosovë, kundër të paditurve N.K, V.K, R.K, B.K, L.K, Sh.K, si dhe D.K, me bazë juridike pengim posedimi.

II. REVOKOHET aktvendimi i kësaj gjykate i datës 29.01.2024, me të cilën është caktuar seanca e vendshqimit për datën 23.02.2024, ora 10:00, nxjerrja e ekspertizës përmes ekspertit gjeodet AS nga Prishtina, si dhe për deponimin e mjeteve në shumën prej 250.00 Euro për përpilimin e ekspertizës, si dhe 20.00 Euro, në emër të shpenzimeve të gjykatës për dalje në teren.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, me datën 30.12.2022, ka ushtruar padi kundër të paditurve, lidhur me pengim posedimin.

Gjykata duke analizuar pretendimet e paraqitura në padi nga paditësja dhe gjatë seancës përgatitore nga i autorizuari i saj, si dhe pretendimet e paraqitura përmes përgjigjes në padi dhe

gjatë seancës përgatitore të datës 29.01.2024, nga e autorizuar e të paditurve, ka ardhur në përfundim se padia e paditëses për shkak pengim posedimit është paraqitur jashtë afatit të paraparë ligjor.

Me dispozitën e nenit 113 par.2 të Ligjit Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore parashihet shprehimisht: *“Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”*, kurse me nenin 114 të po këtij ligji përcaktohet po ashtu se: *“Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi që poseduesi e merr dijëni lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit.”*.

Kurse me dispozitën e nenit 393 të LPK-së, përcaktohet po ashtu se: *“Gjykata, në qoftë se konsideron se nuk ka material procedural të mjaftueshëm për dhënien e aktvendimit mbi ndonjë çështje që është paraqitur gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, do të vendosë lidhur me të pasi të arrijë përgjigja në padi e të paditurit ose gjatë seancës përgatitore apo në seancën për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se nuk është mbajtur seanca përgatitore.”*.

Duke e patur parasysh se Gjykata nuk ka patur material të mjaftueshëm procedural për dhënien e ndonjë vendimi gjatë shqyrtimit të paraprak të padisë gjegjësisht lidhur me afatshmërin e padisë, me datën 29.01.2024 ka mbajtur seancën përgatitore në këtë çështje juridike kontestimore.

Nga shkresat e lëndës gjegjësisht precizimi i padisë me datën 07.11.2023, rezulton se pretendimet se paditëses P.K Sh.p.k., se kur ka ndodhur akti i pengim posedimit nga ana e të paditurve, rezulton të jetë data 17.10.2022 e tutje - në vazhdimësi. Nga deklarimi i të autorizuarit të paditëses në seancën përgatitore, vërtetohet se paditësja fillimisht miqësisht ka kërkuar nga të paditurit që ta mos pengojnë në posedimin e ngastrave kadastrale kontestuese dhe më pas iu është drejtuar Policisë së Kosovës për largimin e veturave të parkuara dhe vetëm pas udhëzimit të Policisë së Kosovës dhe mos reagimit të tyre, lidhur me këtë çështje kanë kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas nenit 113 par.3 lidhur me nenin 114 të LPDTS, në të cilën përcaktohet afati maksimal prej 1 viti nga momenti i pengim posedimit.

Nga ankesat e dorëzuara nga paditësja P.K Sh.p.k., përmes pronarit të saj A.K, të datës 24.10.2022 për Inspektoratin e Policisë së Kosovës dhe ankesën e datës 26.10.2022, për Policinë e Kosovës – Drejtoria Rajonale në Prishtinë dhe Fushë Kosovë, Gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka qenë në dijëni për aktin e pengim posedimit të pretenduar që nga data 24.10.2022 dhe për kryerësit e aktit të tillë të pengimit të posedimit të pretenduar. Kurse padinë në këtë Gjykatë e ka ushtruar me datën 30.12.2022, që do të thotë pas kalimit të mbi dy muajve nga data kur e ka kuptuar aktin e pengim posedimit të pretenduar dhe kryerësit e aktit të tillë. Në prani të një gjendje të tillë faktike vërtetohet pamëdyshje se paditësja ka

lëshuar afatin subjektiv prej 30 ditësh të përcaktuar në nenin 114 të LPDTS, për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Kurse sa i përket pretendimeve të paraqitura nga i autorizuari i paditëses se në rastin konkret afati maskimal për paraqitjen e padisë është 1 (një) vit, Gjykata pretendimin e tillë e vlerësoj si të pa bazuar, ngase meqenëse është lëshuar afati subjektiv prej 30 dite, afati objektiv prej 1 vit nuk gjen zbatim.

Gjykata e ka patur parasysh edhe faktin se në precizimin e padisë të datës 07.11.2023, paditësja ka pretenduar se pengim posedimi ka ndodhur me datën 17.10.2022, e tutje - në vazhdimësi, mirëpo me rastin e vlerësimit të afatshmërisë së padisë gjykata ka patur parasysh datën e veprimit të parë të aktit të pengim posedimit të pretenduar dhe datën kur është vënë në dijeni paditësja për aktin e pengim posedimit të pretenduar dhe kryerësit e saj. Ndërsa për pretendimet e pengimit të posedimit në vazhdimësi, në qoftë se paditësja është poseduese e ngastrave kadastrale kontestuese ende, nuk ka pengesa që të paraqet padi të re, mirëpo gjithnjë duke i respektuar afatet prekluzive të përcaktuara në dispozita ligjore, nga momenti kur vihet në dijeni për aktin e pengim posedimit të pretenduar. Për më tepër qëndrimi i kësaj Gjykate mbështetet edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatave të Republikës së Kosovës, gjegjësisht Përmbledhjen nga Praktika e Gjykatës Supreme në kontestet pronësore Botimi 1, Prishtinë 2019, Rasti 49, faqe 314-317.

Me dispozitën e nenit 391 par.1 pika f) të LPK-së, parashihet: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj”*, e që në rastin konkret afati për paraqitjen e padisë është paraparë me dispozitën e nenit 114 të LPDTS-së, i cili afat është prekluziv dhe humbjen e këtij afati nuk mund të kërkohet mbrojtja gjyqësore, andaj, nga këto arsye gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata ka vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke revokuar aktvendimi e saj të datës 29.01.2024 të marr në procesverbalin e seancës përgatitore, me të cilën është caktuar seanca e vendshqimit për datën 23.02.2024, ora 10:00, nxjerrja e ekspertizës përmes ekspertit gjeodet A.S nga Prishtina, si dhe për deponimin e mjeteve në shumën prej 250.00 Euro për përpilimin e ekspertizës, si dhe 20.00 Euro, në emër të shpenzimeve të gjykatës për dalje në teren. Kjo për arsye se meqenëse padia e paditëses është vërtetuar se është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar ligjor dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës, është revokuar aktvendimi në fjalë. Me dispozitën e nenit 10 par.1 të LPK-së, është përcaktuar se: *“Gjykata ka për detyrë të përpiket që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”*. Andaj, në prani të këtyre rrethanave, Gjykata ka vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale, Gjykata e ka marr duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 450 LPK-së. Kjo për faktin se me dispozitën e nenit 463

par.1 të LPK-së, përcaktohet në mënyrë të qartë: *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”*, kurse e autorizuar e të paditurve, nuk i ka specifikuar lartësinë shpenzimeve të procedurës kontestimore edhe pse një obligim i tillë rezulton me paragrafin 2 të nenit 463 të LPK-së, në të cilin parashihet: *“Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës.”*

Nga këto arsye, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C. nr.7480/22, datë 01.02.2024

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa, në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.